



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË NJËMBËDHJET TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Mbledhja është mbajtur më 03.12.2018 (e Hëne) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira, nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu; këshilltarët e Kuvendit: Basri Sylejmani, Rufadije Halimi-Rexhepi, Valbona Haziri, Ali Bajrami, Xhilsime Qamili, Nuredin Lutfiu, Zekirja Zuka, Blerina Lubishtani, Afrim Ramushi, Nijazi Isaku, Jakup Demiri, Sejdi Emini, Remzi Salihu, Mirlinda Sadiku, Liridona Bislimi, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Samet Idrizi, Idajete Pira, Avdi Rexhepi, Ekrem Abazi, Vehbi Rama, Valentina Hasani, Rasim Terziqi, Besim Ymeri. Ndërsa mungoi (Vjollca Kadolli-Halili pasi që ka ofruar dorëheqje nga se që është zgjedhur drejtoresh e QKM-së në Viti . Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, zyra për Barazi Gjinore,.

Pasi u konstatua se prezent janë 26 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e dhjet të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të përshëndes nënkryetarin e Komunës, z.Hasan Aliu, juve të respektoj këshilltar komunal, drejtorë të drejtorive të cilët janë prezent në këtë seancë, përfaqësuesit e OSBE-së, mediat e shkruara dhe të gjithë të tjerët që janë prezent. Ju njoftoj, që nga MAPL-ja kemi pranuar konfirmimin e disa akteve, të cilët janë miratua në seancën e fundit të kuvendit komunal. Diçka tjetër të veçantë nuk kam, por para se të hymë në rendin e ditës i kemi bërë pyetje dhe propozime jashtë rendit të ditës, kështu që fjala është për ju.

znj. Gjylsime Qamili: Përshëndetje për të pranishmit, unë sot kam një pyetje për drejtoreshën e Arsimit. E keni përmend një dokument për digjitalizimin nëpër shkollat e Komunës së Vitisë, si e parashini ju dhe deri ku kanë arritur procedurat deri me tani.

z.Sejdi Emini: Pikërisht do të lidhem edhe unë me drejtoreshën e Arsimit, pasi që doktoresha Gjylë vetëm se i bani disa pyetje, unë drejtoreshës në fillim i kam pas thanë se ke me pas sukses nëse nuk varësh nga politika dhe jam mese i sigurt se nëse nuk ndikohet nga politika ka me pas sukses, mirëpo kështu qysh është, po të tregoj se ndoshta ma mirë mos është me dhanë dorëheqje qysh ka pas dhanë Shefik Sadiku, e ka dal faqe bardh, të jesh e bindur se ma vonë ke me i pa këto sende. Në shkollat ku punojmë sot ne, po nisëm prej shkollës ku jam unë nuk ka ngjyrë as për fotokopje. Xhamat e shkollës kemi bërë kërkesë qe 2 muaj me i rregullua në këtë kohë të ftoftë, tash i kemi mbi 30 lule të gjalla në korridor, ku moment se ka temperatura në minus edhe ato kanë me u prishë. Një dukuri që më shqetëson pak ma shumë, droga në shkolla. E kam ngrit edhe ma herët po e ngris edhe sot, duhet me pas strategji që me rritë kontrollin edhe me qenë sa ma të kujdesshëm, sepse është mosha e tyre ku mundet me u rritë numri, veç kemi pas edhe raste mos të kishim pas raste nuk e kisha përmend. Shkollën

e Germovës, ka qenë një kaos për shkak të dy- tri dyerve, dy muaj ndoshta ti nuk ke faj, por nuk e di qysh po ja lejoni atyre zotërive që marrin tenderët me ju prua në këtë gjendje. Se kryen punën, këputja bre kontratën, nuk bëhet nami. Te rrugët, puna që po kryhet askush nuk mundet me thanë që nuk është ka punohet, sytë janë me pa, por këto punë janë aq afat shkurte sa që njëjtin buxhet njëjtat para kemi mu detyruar prapë pas dy tri viteve mi bë. 290 mijë euro janë dhanë në rrugën e Gushicës, që ka qenë shumë e nevojshme, hajde sot shkojmë dhe e shohim si ka kupë asfalti e kujt është kjo para, a ka dhanë dikush pare prej gjepi të vet, jo është pare e qytetareve, por po them prapë që kompanitë janë tu bërë qysh janë tu dashtë, qysh janë tu gjete. Edhe këtu në Viti ka disa rrugë që ende nuk janë asfaltuar, duhet të ju jepet prioritet, tash është kohë dimri krejt ajo balt ka me dal prej atyre rrugicave në qytet, duhet me ju dhanë prioritet edhe atyre rrugëve me i shtrua. Një rrugë te Sokolët, në mandatin e qeverisë së kaluar më duket u ndreqë te lugina, po pse bre po e leni ashtu, a veç me tregu qysh ata qysh janë kanë, qysh kanë punua, nuk është zgjidhje ajo nuk është kosto ajo, unë mendoj se duhet me intervenua aty se qytetarët po e pësojnë, edhe një pyetje për DKA-në, a lejohet të lypën para nga nxënësit për të rregulluar shkollën klasën apo një derë e që kjo po ndodhë. Na kemi bërë shumë punë nëpër shkolla, punë vullnetare me prind, a mi kushtëzua nuk është mirë. Nënkryetar, e kam dëgjua debatin që e ke pas me zv.ministrin Rexhep Kadria, nuk e di çka donë me thanë për juve me lyp kohë edhe me lyp hapësirë që mi qua sendet deri në fund, për mua fare nuk ka qenë i sinqertë në raport me qytetarët, bile kam informacion që jeni marr vesh hala pa hy në debat që jeni marr vesh mos me nguc njëri tjetrin, kjo nuk lejohet, nëse ja bani këtë qytetareve, po të tregoj se nuk e di pse rrini edhe në pushtet.

z.Bekim Azizi: Sot isha lidh me një shqetësim prej QKMF-së, ku një mjek që e keni pranuar që është në punë, jashtë çdo sistemi, çdo norme, çdo rregulle dhe jep një pacientit një infuzion tetë bendedina në të njëjtën kohë dhe tentohet si rast të fshihet, ku rasti tash është edhe në hetime. Besoj që e dinë drejtor për kanë është fjala dhe cilat janë masat që keni marr për këtë rast? Nuk është rasti i parë te ky mjek, se ka edhe skandale tjera, është shqetësim edhe i mjekeve tjerë, është shqetësim edhe i drejtoreshës për këtë rast njeriu ju ka mbet shtrirë, kanë ndërhy shpejt dhe e keni shpëtua momentin e fundit. Drejtoresh e arsimit, një pyetje që ta kam bërë në seancën e kaluar, ke thanë që nuk ke ndonjë informatë, më intereson a ke informatë sot për atë rast dhe më intereson me dit sa drejtorëve ja u ke vazhdua mandatin pa konkurs dhe cilët janë. Edhe një është shqetësim i madh në punimet që janë bërë në asfaltimin prej xhamie deri te “Lindi”. janë fotot pas dy dite tu i qit nxiftin edhe zall tu i mbulua ato vija që janë bërë, por edhe rruga e Pozheranit që është bërë aty nuk është bërë punë e mirë, kapakët janë mbuluar me asfalt edhe në çfarë gjendje është besoj se para se me e rregullua ka qenë në gjendje ma të mirë.

z.Basri Sylejmani: Unë kisha mi bë nja tri pyetje, për drejtorin e Inspeksionit në Germovë, është duke u ndërtuar një objekt, a ka leje? Për drejtorin e Shërbimeve Publike, për ujin në Letnicë, shumë herë e kemi diskutuar, por hala nuk u bë asgjë. Edhe për shokun që diskutoj Bekimi, ja pranoj për rrugët kush e ka shtrua nuk e di, veç keq u ba.

z.Nuredin Lutfiu: Kam një kërkesë nga banoret e lagjes “14 Qershori” në Viti, në këtë rrugë mungon edhe ndriçimi publik edhe trotuari. Edhe një kërkesë e kam bërë për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, është një pusëtë aty, ku cila mblidhet uji rregullisht, nuk u ndërmarr asgjë aty, edhe një kërkesë tjetër nga banoret e fshatit skifteraj të lagjes Rrustë Sadiku dhe lagjes së rrugës 15 prilli, e cila bashkon rrugën me xhamin e vjetër. Kam një pyetje për ndriçim publik, a është në projekt këtë vit a vitin tjetër.

z.Jakup Demiri: Kam një pyetje këtu për drejtorin e Inspeksionit në lidhje me problematiken e zhurmës së restorant “Lindit”, përkatësisht matjeve që janë bërë në muajin shtator, çka kanë rezultuar dhe çka keni ndërmarr se tash jemi në muajin dhjetor, ka ahengje dasma. Këtu u tha shumë për rrugën te xhamia dhe te rruga e Pozheranit, s’po lidhem edhe shumë veç po dua me thanë që në çfarë gjendje ka qenë edhe në çfarë u bë. Unë mendoj se u bë ma keq.

z.Avdi Rexhepi: Informatë rrethe rikyqjës në ujësjellësin e Letnicës.

z.Ali Bajrami: un kisha një pyetje për drejtorin e inspeksionit me aplikimin e taksës 100% nga Kryeministri. Çfarë veprime ka ndërmarr inspeksioni i tregut në Komunën e Vitisë për largimin e mallrave me origjinë nga dy shtete ndaj është aplikuar kjo taksë.

z.Njazi Isaku: Unë dua me ngrit një shqetësim të lagjes, rruga “Idriz Seferi”. Punimet që i ka bë një kompani që ish ajo tash e njohur, që i fiton tenderët, se ish militant i LDK-së. Dua mu ndërlidh, një shqetësim, një javë dit na i ka prish rrugën edhe nuk na ka lanë kyqje në oborr edhe unë nuk disha ku me bë ankesën, nuk kisha zgjidhje, vetëm në aspektin fizik se nuk kisha kanë me njoftua krejt shtëpive tjera ju la kyqje në shtëpi a te unë ndodhi që nuk la kyqje. Ajo haptas u pake se e bëri qëllimisht në raport ndaj meje edhe në fund qa ka ndodh nuk e di, veç në fund i kanë tepruar kubzat që ka qenë trotuari i vjetër dhe unë i kam pyetur punëtorët. ma kanë vërtetuar se po kanë tepruar. Edhe unë pajtohem me shqetësimin e Bekimit për rrugët që janë shtruar te xhamia dhe te rruga e Pozheranit.

z.Taulant Haxhiu: Përshëndetje të nderuar koleg! Është hera e tretë që dal dhe e kërkoj të njëjtën gjë kontratat mbi vepër, kontratat mbi vepër. Jam ka i kërkoj nga komuna ti shof nëse jeni transparent dhe nuk ka aty diçka që po mendoj unë, atëherë ofromi kontratat, por besoni që kjo është hera e fundit që i kërkoj kontratat, tash e tutje do të vazhdoj procedurat tjera. Kam qenë edhe te Mustafa, deshta të bëjë një kërkesë po thash edhe njëherë pasi që kam munguar në seancën e kaluar. Tash po i kërkoj, nëse nuk vinë kontratat në seancën e radhës, atëherë Vitia do të bombardohet nga mediat e ndryshme. Ju e dini që fuqinë e mediave e kam kogjo të madhe. Rruga Pozharan-Viti, unë aty jetoj dhe veproj, nuk e di kush e ka ndreq at rrugë, veç sa e ka prish as në kohën e Serbisë nuk u kanë më keq se sa është sot. Du një informatë edhe për këtë. Dhe pyetjen e tret e kame të shkollat e mesme, një ure që është ndertu kam disa informata prej militantëve të LDK-së, që ajo urë kush e ka dhënë tenderin, me qenë se edhe kam të drejtë me pa kush e ka dhënë tenderin dhe sa është vlera, me ka thanë një militant i LDK-së, që ajo ure ka kushtu si me pas qenë ura e San Franciskos. Unë du informatë sa është vlera, ajo është dhënë me tender, mirëpo ka kushtu tepër shtrejt ura që është ndertu të shkollat e mesme dhe fituesi i tenderit ka qenë një familjar i njëres prej drejtoreshave të Kuvendit Komunal të Vitisë. Kjo është një konflikt interesi. Ju lutem që të ma jepni një informatë të sigurt, se sa ka kushtu ura të shkollat e mesme.

znj.Mirlinda Sadiku: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Faleminderit plus tv që po bëni një dritare për me pas qasje publiku, se çka po diskutohet, se pikërisht këto pyetjet që po parashtrohet kanë të bëjnë me përditshmërinë e qytetarëve, do të kisha thënë se shpeshherë në situata të caktuara njerëz të caktuar bëjnë presion për mos me than fjalën ajo me garantohet me kushtetutë, me garantohet me ligjet në fuqi, prandaj mos harroni se nuk mund të me frikësoni me çfarë do mënyre, koftë të shantazhit që mund të ja mbyllni gojën Mirlinda Sadikut. Këtu jam për qytetaret e kame besimin e tyre çdo herë do të jem në shërbim të tyre. Pyetjet që i kame për ekzekutivin janë, Drejtoria e Inspeksionit ka pranuar kërkesë me shkrim të protokolluar nga Lëvizja Vetëvendosje lidhur me inspektimin e ujit nëpër shkolla, ende nuk kemi marr përgjigjeje që dy muaj. Pyetja e dytë, raport financiar ka kërkuar Lëvizja Vetëvendosje lidhur me ambulanten që është në përfundim e sipër në fshatin Skifteraj. As kjo nuk na është ofruar, drejtori i Financave nuk qenka këtu. Po me intereson procesi i bursave deri ku ka ardh, e di që ka qenë konkursi publik, Komuna e Gjilanit sipas portalin info komuna, i cili portal zakonisht merrt me problematikat dhe të rehat nëpër komuna, këtë vit ka bë shujta për fëmijët, është pilot projekt, ka filluar me tri shkolla, a do të ketë Vitia një projekt të tillë ne te ardhme, kur e dimë që sipas buxheti të ri 40 milion euro komunat kane me i perfitu ne total ne Republikën e Kosovës dhe pyetje shume me rëndësi edhe drejtoresha para tri vite ka bë pyetje për një çerdhe në Pozharan, a do të behet Pozharani me çerdhe publike, po ose jo? E kame dëgjuar prononcimin e juaj në media, e di që ki problem me staf nga Ministria e Arsimit, mirëpo ta kemi një përgjigje pasi që edhe keni premtuar në fushatë. Pyetja tjetër, e di që ura te shkolla e mesme profesionale ka qenë investim i Ministrisë së Infrastrukturës, ka kushtu dikun rreth 200 mije euro, nuk e di a ekziston mundësia që të bëhet një rrethoj, një mbrojtëse aty ku njerëzit presin te stacioni i autobusëve, është shume e domosdoshme, ka pas edhe një reagim nga një anëtar i EVSB-së Imri Emerllahu, mirëpo edhe unë mendoj që është shumë e nevojshme dhe e domosdoshme. Kam pyetje për drejtorin e Bujqësisë, është pyetje shume me rëndësi për arsye, se sipas informacioneve të ofruara nga info komuna, se ne vërshimet të cilat kanë ndodhur në fshatin Mamush,

qeveria vetëm i ka zotë 400 mijë euro për fermerët e asaj komune, d.m.th edhe ata do të kompensohen nga Ministria e Financave, po ashtu edhe Vitia ka pas dëme, e dimë shumë mire, madje me një raport që naj ka ofru drejtori, janë dikun të dëmtuar rreth 139 hektar dhe gjithsej kanë qenë 53 fermer. Nëse Mamusha ka marr kompensim, pse mos me marr ose te subvencionohen edhe fermerët e Komunës së Vitisë.

z.Ekrem Abazi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kame një pyetje për pushtetin. Cili është kriteri për punësim në Komunën e Vitisë. E dimë që konkursi i jep kriteret për punësim, po ato kriteret janë vetëm sa për sy e faqe. Unë personalisht mendoj që për mu punësu në Komunën e Vitisë duhet me qenë me një parti që është në pushtet, duhet mu kanë i klaneve të këtyre që janë tu e udhëheq Komunën e Vitisë, duhet mu kane njeri i pasur, se pa u kanë i pasur sun hinë në punë, duhet mu kane pak me at pushtetin që ka shku me herët, duhet mi pas të gjithë të punësuar në familje, e për mu punësu edhe ai duhet mu bë disa pazare tinxa që i bëjnë, d.m.th mendimi im prej këtyre që i thash ka hala tjetra, d.m.th pa u plotësua njeri nga qeto kriteret, absolut nuk punësohet kërkuesh. E di që me kanë me një parti politike nëse me kushtet të njëjta jam për me marr të qasaj partie politike, sepse partia politike për qeta ka fitu, po jo dikujna me ja rujt vendin ka 6 muaj ditë, deri sa të diplomojnë e dikujna çka i ka bë 10 vjet me diplomë kurr nuk punësohet, dikush hala pa diplomu i ruhet vendi, at ditë që diplomon të nesërit shkon në punë. Kjo është për marri, ky është mendimi im. Dua mu përgjig nga pushteti, a është kështu a jo, se unë muj edhe me emër mi thanë, guxojmë mi thanë.

z.Rasim Terziqi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Shfrytëzoj rrasatin të i uroj drejtoreshës punë të mbarë. Kam disa pyetje dhe kam një kërkesë të parku që është tu ndërta në Lagjen “Demiri” dhe “Salihu”, kame një kërkesë prej banorëve që të pastrohet ajo prrocka aty, se zakonisht kur po ka vërshime po del ka shtrati, po shkakton probleme dhe ka kërkesë që të futen në sistemin e menaxhimit disa shtëpi aty në sistem të kanalizimit, sepse nuk ka të kyqyr në sistem të kanalizimit. Pyetje tjetër, e kemi nxjerr një rekomandim prej mbledhjes së Komitetit për Komunitete, që komuniteti kroat në Letnicë të ju ndihmohet me një pako ushqimore, me dru, sepse vërtet 12-13 familje ishin aty në gjendje të mjerueshme. Kemi pas planifikim që të vizitojmë komuniteti Kroat në Letnicë, mirëpo në nuk mund ta vizitojmë nëse nuk ka diçka konkrete, që të ju afrojmë në. Edhe pyetja tjetër rreth kazinove dhe bastoreve që kane pushtu Komunën e Vitisë, çka mund të bëjmë në Komuna e Vitisë. Unë e di që me këtë punë merret niveli qendror, po na nuk mund të mbyllmi, mirëpo a mujm t’i taksojmë ato me taksa komunale, se ato vërtet janë biznese që kanë të hyra shume të mëdha, e vërtet është gjendje e keqe që po e prek shoqërinë tone, a mundet që këto bastore e kazinove qe ti taksojmë me taksë komunale.

z.Samet Idrizi: I nderuar kryesues, nënkryetar, koleg asamblist, ju ekzekutivi dhe të tjerët të pranishëm! Unë kam një pyetje që ndërldhet me duket me legjislaturën e parë a po të dytën të PDK-së, kur ka qenë në pushtet, kemi një vendim të kuvendit këtu, unë e kisha lexuar, është i datës 08.10.2009 vendim për ndarjen e lokacionit për vendosjen e shtatores së dëshmorit të kombit “Bafti Haxhiu”. Unë nuk po e lexoj krejt vendimin, lokacioni është i ndarë. Po kaloj të neni 3 i këtij vendimi, i cili thotë: mjetet për ngritjen e shtatores së dëshmorit “Bafti Haxhiu” do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Vitisë. Mu po me intereson me pyet se vendimet kur të nxirën nga kuvendi duhet edhe mu zbatu, e gati 10 vjet kanë kaluar prej këtij vendimi edhe personalisht kam prit një kohë qe po aktivizohet prej instancave përkatëse, po nuk u aktivizu, ndërsa neni 4 thotë: “që për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër, Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Shërbime Publike. Ky vendim ka hy në fuqi datën që e ceka me lartë, megjithatë, se vitin e ardhshëm dëshmori i kombit “Bafti Haxhiu” bënë 20 vjet nga renia e tij për lirinë e Kosovës. Është mirë me bë diçka në Kuvend, po edhe ekzekutivi. Njëkohësisht unë propozoj me shku në Komitet për Politik dhe Financa, me u diskutu në mbledhjen e radhës, se çka mujm me bë dhe me shty tutje këtë vendim.

znj.Valentina Hasani: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Ujësjiellësi, kanalizimi dhe 99% të rrugëve në fshatin Drobesh janë kryer gjatë mandatit sa ka qenë zoti Nexhmedin Arifi dhe çka dua të them, se është mandati i dytë a po viti i 5 qe ju jeni tu e qeveris Vitin dhe perveq atyre dritave qe janë vendos në fshatin tone edhe ato jo në mënyrë të duhur e qe as në hyrje të fshatit nuk ka. Unë nuk e di, në kemi punuar diçka tjetër, pse trotuari në rrugën kryesore rr. “Ibrahim Rugova” nuk ka përfunduar që

disa vite, besa as ndriçim nuk ka dhe drejtoresh, siç e dimë, kërkesa në Ministri të Arsimit është bërë për t'u ndërtuar shkolla e re ne Drobesh, kur do të kthehet kjo përgjigjeje?

znj.Liridona Bislimi: Përsëritet të nderuar të pranishëm! Siç e dinë të gjithë, këtë vit kryetari Sokol Haliti ka shpallu vit të ambientit, është mundu disa me i bërë reklamë veten në mënyrë të ndershme, dijet që “EkoHigjena” i takon një komune tjetër, gjysë për gjysë, si dhe qyteti i Vitisë shumicën e kohës është i mbushur me mbeturina, po çka na ka ra ne sy neve Lëvizjes Vetëvendosje është formu një deponi e mbeturinave të ish kampi i ushtrisë amerikane, tash saktësisht ai vend përdoret për poligon për autoshkollat. Tash është në këtë gjendje, shi foto, deshta ta ceku se me 15 Shtator në Klan Kosova kryetari ynë e ka bërë një intervistë dhe ka thënë që Vitia nuk ka nevojë për pastrim. Kjo e demanton se Vitia vazhdimisht ka nevojë për pastrim, të gjitha vendet kanë nevojë për pastrim e leje ma qyteti i Vitisë. LVV e ka vizituar familjen Isufi, e cila jeton këtu në Komunën e Vitisë, ajo ka gjetur strehim nga paslufta me një shtëpi që është gati e rënuar, ne kemi vizitu këtë familje dhe me të vërtet jemi të shqetësuar. Gjendja e kësaj familje është pasqyru edhe në Plus Tv, ju pyes si do të veprojnë komuna me këtë familje, a do ti ofron ndihmë. Edhe një pyetje që është duke i ripërsëritur që 5 vite, nënkalimi në fshatin Drobesh, rruga kryesore kur do të behet.

Drejtoresha znj.Fatbardha Emini: Përsëritet të nderuar të pranishëm! Po mundohem me ju përgjigj pyetjeve të parashtruara. Lidhur me pyetjen e doktoreshës Gjylë, lidhur me projektin e digjitalizimit e shkollave, i cili është nënshkruar dikun nga fundi i shtatorit me fondacionin e Luxemburgut, projekti është në fazën përfundimtare, është bërë instalimi i rrjetit nëpër shkolla, edhe pajisjet po priten deri ka fundi i këtij muaji, lloptopët, projektorët me u shpërnda nëpër shkolla sipas prioriteteve që i kemi parapa, në bazë të kërkesave që i kanë shkollat tu e pa mungesën e pajisjeve që i kanë edhe trajnimi i mësimit është mbajtur për një fazë. Tash fillon për mësimit të tjerë, trajnimi, që të kenë njohuri për përdorimin e këtyre pajisjeve, Sejda i tha disa konstatime dhe disa kërkesa lidhur me xhamat në Gushicë, ka qenë inicimi im që i kam pa vet në korridor, përndryshe kemi probleme me disa operator. Ju kam shkruar vërejtje që po i vonojnë kërkesat që i kanë shkollat, tu e ditë që procesi shkollor nuk pret për ngjyrë e letër. Informatat që i kam tash prej Zyrës së Informimit, është kontraktuar kompania për ngjyrë. Një konstatim i padrejtë. Sa i përket drogave nëpër shkolla, unë jam anëtar i KKSB-së dhe kemi takime të rregullta me drejtor, sidomos me drejtorët e shkollave të mesme takim të veçantë, edhe për këto probleme ku kërkohet që vazhdimisht të përdoret edhe taks forca e të pa planifikuara me herët dhe nuk e kam këtë informatë që përdoret droga nëpër shkolla, as nga policia nuk e kam këtë informatë. Është konstatim i rand nga ju që e thuani. Sejda ma kërkoj edhe dorëheqjen, po është e vërtet se kame pozitë politike dhe asnjëherë nuk e mohoj këtë dhe me krenari gjithëherë e barti, po e di që disave ndoshta ju pengon kjo, kthimi i ligjshmërisë në Drejtorinë e Arsimit dhe ndoshta kjo po ju pengon dhe po e kërkoni dorëheqjen time, po këtë e bëjë unë kur të me kërkon ai që me ka emëru. Bekimi e tha për vazhdimin e mandatit të drejtorëve, Udhëzimi Administrativ për përzgjedhjen e drejtorëve e parasheh që drejtorët në bazë të performancës që e kanë, munden me ju vazhdu mandati për një kohë të caktuar apo edhe për një mandat nëse kanë performancë të mirë. Edhe drejtorëve që u është vazhdu mandati në shtator, kanë tregu performancë të mirë, e në bazë të performancës që e kanë edhe kemi pa të arsyeshëm se bashku me kryetarin me propozimin tim, që atyre të ju vazhdohet mandati. Disa janë edhe afër mandatit, krejt kjo është në bazë të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit. Për shqetësimin që e ka ngrit Bekmi, në seancën e kaluar e kam thirr drejtoreshën, e kemi diskutu këtë çështje edhe me mësimit të tjerë, kemi bisedu, ka qenë një keqkuptim lidhur me atë nxënë, asnjëherë nuk e ka largu nga ora mësimit at nxënë, po për shkak të disa rrethanave tjetra ndoshta është njerëzore mos me i pamend këtu, për shkak të privatësisë të nxënësit. Mirlinda e ngriti çështjen e bursave, ka përfunduar thirrja publike, komisioni është i caktuar, është duke e bërë vlerësimin e kandidatëve që kanë aplikuar, nuk e di deri ku kanë arrit me punë, po besoj që do të bëjnë punën e duhur. Shujta për nxënësit, është një performancë edhe një nevojë e mirë, sidomos për nxënësit e shkollave fillore, me që kanë obligativ mësimit e shkollës fillore, po kjo ka të bëjë me planifikimin, përderisa nuk kemi planifikim të tillë, mbetet si dëshirë që të realizohet vitet e ardhshme. Çerdhja publike në Qifllak, është e vërtet që është premtim dhe po bëjmë përpjekje me e realizu këtë premtim, do të gjejmë forma të ndryshme nëse nuk

na përkrah ministria, atëherë do të keshyrimi me mundësi vetanake, që këtë shkollën në Qifllak ta shndërrojme ne çerdhe. Mirë, duhet të kemi personel arsimor, ju kemi drejtu edhe komisionit parlamentar për buxhet, që ende nuk e kanë miratu buxhetin për vitin e ardhshëm, së bashku edhe me shkollën e Drobeshit, po edhe për personelin arsimor ne Qifllak, që të rritet numri i planifikimit të mësimdhënësve dhe edukatorëve, e stafit përcjellës ne Qifllak.

z.Basri Aliu Drejtor: Përsëritet të nderuar të pranishëm! Bekimi e ngriti një shqetësim për një palë, e cila ka bërë një ankesë lidhje me një rast për mjekun këtu me terapi, ndoshta ka gabu, por masat të cilat janë marr ne Qendrën e Mjekësisë Familjare, pasi që rasti ka të bëjë me anenë profesionale, është në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, është këshilli profesional i cili merret me shqyrtimin e këtyre rasteve dhe iniciativë të këtyre këshillit e ka marr në këtë rast, po nuk është ashtu siç e tha Beka. Ndërsa çështje tjera, se a ka ngrit padi apo jo, ajo është çështje private e çdo personi i cili do të merret me ta mjeku, si çdo mjek tjetër është pranë sipas konkursit me komision, i cili ka qenë profesional, mjeku e ka licencën që e ka kry fakultetin, ndërsa Ministria e Shëndetësisë, për nga ana profesionale unë nuk mundem të merrem me ta.

znj Xhilsime Qamili: Përsëritet Bekim. Kërkoj falje, por ai që ta ka dhënë këtë informatë që janë 8 bensidina, le të tërhiqet prej asaj informate, se me ju dhënë 8 bensidina është akuzë e randë të akuzohet doktori apo qendra, po dy bensidina është, behet fjalë për dy bensidina çka janë bërë të gjitha hulumtimet nga komisioni profesional, nga komisioni etiko profesional i Qendrës së Mjekësisë Familjare dhe aty vërtetohet se nuk janë dhënë as dy bensidina, po sidoqoftë bëhet fjalë për dy bensidina. Doktori, sjelljet e doktorit krejt është i licencuar, po kush ti ka dhënë ato të dhëna ty le të tërhiqet nga ato, po edhe ju mos rrini në at që janë dhënë 8 bensidina.

z.Skender Ahmeti Drejtor: Përsëritet për të gjithë të pranishmit! Përgjigje e parë, ka fillu atje një objekt të ndërtohet inspektorët e ndërtimi, kanë qenë atje kanë marr masat procedurale që do të vazhdohet tutje. Leje nuk ka ai për momentin, po do ta shofim tash e tutje çka do të behet. Jakupi pyeti për çështjen e zhurmës të restorant “Lindi”, që është bërë hit gati për çdo seancë. Ne kemi mat, e kemi detyru një kompani që ta mat zhurmët tek ai restorant, rezultatet zyrtare nuk ka i ka ofru kompania për shkak se nuk ju ka bërë pagesa e ekspertizës, as nga restoranti “Lindi” e as nga ankuesit, por megjithatë masi nuk është dhënë rezultati, ne kemi dyshuar që ka qenë tejkallim i zhurmës nga restoranti dhe e kemi procedu një lëndë për në gjykatë, e kemi procedu lëndën në gjykatë edhe pse nuk kemi pas rezultat zyrtar të konfirmimit të analizës, ndërsa hedhja e fishekzjarrëve, qitja me armë, zhurma e banorëve që dalin jashtë sallës nuk është kompetencë e Drejtorisë së Inspeksionit dhe nuk merret me atë çështje. Pyetja tjetër nga Ali Bajrami, rreth aplikimi të taksës 100%, çfarë janë marr masat nga Drejtoria e Inspeksionit në Komunën e Vitisë. Unë kisha menduar, se pas lëshimit të urdhërësës që e ka bërë Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për mallrat të cilët kanë mbishkrimi që nuk janë konform ligjeve dhe kushtetutës së Republikës së Kosovës, me ato kemi pas me u marr dhe me ato kemi marr vazhdimisht inspektorët e tregut në tërë javën. Ju kam dhënë prioritet që të gjithë artikujt ushqimor që kanë mbishkrim të ndryshëm nga jo që është e ligjshme ti etiketoj dhe t’i largojnë nga qarkullimi dhe për këtë gj që e kemi bërë ne e kemi njoftu edhe Ministrinë e Tregtisë dhe kryeinspektorin e saj dhe e kemi njoftu edhe për një dukuri që po paraqitet vendosja e tiketave mbi përshkrimet e paligjshme që janë në artikujt ushqimor. Për fat hala nuk kemi përgjigje nga MTI-ja edhe kemi presim veprimet e mëtutjeshme se çka do të bëjmë tutje. Në të njëjtën kohë kemi bërë edhe inspektimin e të gjitha furrave të bukës, që të identifikojmë se a ka tejkallime të peshave të bukës, që është një mashtrim për konsumatorët dhe çmimeve e cila duhet të jete publike para çdo furre të bukës deklaracioni, pesha dhe çmimi i saj dhe këtë do ta përcjellim ne vazhdimësi dhe e kemi përcjell gjatë tërë javës. Patëm një pyetje te inspektimi i ujërave që është bërë një kërkesë me shkrim. Unë përgjigjen me shkrim ku e kam marr automatikisht ju kam përgjigj, të kisha pyet zotëri Jakupi, se e kam pyet edhe posten, se unë përgjigje e kam dhënë me kohë. A e keni marr a po nuk e keni marr, se posta e administratës mu më ka konfirmu se ja kemi dhanë Jakupit ne dorë. Po dua me e konfirmua se çdo përgjigje me shkrim, unë edhe përgjigje me telefonata ju përgjigjem e le ma atyre me shkrim kemi mbi 100 vërtetime të studenteve të Vitisë, pa procedurë me shkrim për me ju dhënë përgjigjen për me e marr strehimi në banimin ne konvikt.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Ishin disa pyetje që meritojnë përgjigje. Si me ju përgjigj Sejdes. Çështja e frikës a është ministër a zv, ministër, çështja respektit në aspektin njerëzor edhe moral që e kemi obligim, që ka qenë në shtëpinë tonë, është diçka tjetër, sa i përket marrëveshjes kanë qenë edhe këta te televizionit aty prezent, as që është bisedua. Ai e ka thanë mendimin e vet, unë e kam than timin, prandaj është mirë në këto çështje mos me u thirre, por unë e di fort mirë se edhe Sejda e din fort mirë, që kjo nuk qëndron, por është vetëm hajde të them diçka të jem ma atraktiv, kjo është diçka tjetër. Sa i përket televizionit, unë e kam thanë ashtu si e mendoj edhe si pushtet edhe si individ. Ato që po i thua ti asnjë nuk qëndrojnë. Shqetësimet te asfaltimi prej rrethi te “Lindi” edhe të mijat janë, po megjithatë janë komisionet pranuese të cilat e kanë obligim për me pranua punën dhe që marrin përsipër edhe çështjen a u punua konform kontratave, por në fund edhe mua mu ka dok se nuk është mirë. A do të ketë ndreqim publik në rrugët që i përmendi Nura, nuk e di a janë të parapara, megjithatë një herë është mirë t’i bëjmë rrugët kryesore. Informatë a do të ketë kyçje, u kanë mirë me ju drejtua “Hidra Moravës” Avdi, ata të tregojnë saktësisht. Njazi, po më vjen shumë keq për shqetësimin që e paraqite, por tani tjetra më ka ardhur se e ke ditë fort mirë, ke thanë nuk kam ditë kujt me ju drejtua, ti je jurist me ju drejtua, ke mund me ju drejtua edhe organeve mbikëqyrës dhe ke mund vetëm një telefonatë në adresë të komunës edhe ajo punë ish krye, se nuk është kuvendi për këto punë. Taulant, na ta kemi përgatitur këtë informacion, po ti nuk ke qenë a me ditë që je kaq i fort në media, kom pas qejf me ta ndal e me këqyr qa po banë. Informatë lidhur me urat, edhe këtë nuk është problematik, mundesh me marr nuk është problem kjo çështje. Një kërkesë ishte te stacioni, ura të ketë mbajtëse, por nuk e di a është në projekt. Cilat kriteret duhet me i plotësua për me u punësua në Komunë. Unë besoj se kriteret ligjore që përcaktohen me ligj. Rasim, nuk e di a është e përfshirë ajo prrockë me u pastrua, ndërsa në sistem të kanalizimit është mirë me ja bë një shkresë inspeksionit, me dal dhe mi detyruar brenda një kohe shumë të shkurtër mi kyç ata. Ndihmë për kroatët, na gjithëherë ju kemi ndihmua, do të ju ndihmojmë edhe këtë vit. Sameti e ka bë një pyetje, shqetësim i tij ka qenë edhe i joni, por megjithatë kjo është një vendim të cilën na i kanë lënë barrë. Ti e dinë se ai vendim ma shumë është marr politik se realizues, na diçka kemi bë, e kemi bë një bazë, megjithatë nuk është e letë, duhet ta kuptojmë se kemi shumë raste të tilla, duhet të jemi parimor, prandaj besoj se për vitin 2019 nuk kemi asnjë mundësi, për arsye se nuk kemi nda buxhet për të, megjithatë duhet ta shikojmë. Valentina, dritat trotuari, edhe nuk keni bë kurrëgjë në Drobesh, fatmirësisht që nuk pasmi bë, se paskan qenë të kryera të gjitha. Unë e di se kemi bë, se kanë qenë disa rrugica si shumë që i kemi kryer. Për shkollë jemi duke bërë përpjekje maksimale. Tjetra, tha kur do të bëhet nënkalmi në Drobesh, nuk kokshe konsultua me prindin tënd, se ai na tha vetëm do vija a mundeni me na i bë edhe ato i kemi kryer.

Po konsideroj, se pyetjet që janë drejtuar në adresë të kabinetit erdha në përfundim, faleminderit shumë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Po, do të ju jap nga një minutë atyre që ju u ka përmend emrin.

z.Sejdi Emini: Me të vërtetë familjen me politikën dua ti ndaj, se familja është e shenjtë. Nuk mendoj se të preka në aspektin familjar fare, nëse donë ti politikisht kështu me luajt, luaj, po besoj që ta kuptojnë të gjithë këtë qasje. E dyta, sa i përket vizionit politik që nuk pasmi na, vizion politik me pas pas ju, sot ish kyçja në autostradë. Kjo është fakt, pikërisht për shkak të vizionit politik dhe për shkak të vizionit politik të dobët që jeni kanë të dorës së dytë, dhe kanë lu me ju si të ishin fëmijë. Ata na kanë sjell në këtë dregje ku jemi, këto janë fakte. Nënkryetar, jemi të sinqertë 100%, sa i përket kësaj pike, asnjëherë nuk kemi thanë hajde masë nesh, por gjithëherë kemi thanë prini, keni përgjegjësi, na keni mbrapa pa asnjë kusht, nuk e keni bërë këtë edhe nuk tërhiqem prej kësaj, është politike, jo familjare, që në Plus TV keni luajtur me qytetar.

z.Njazi Isaku: Nënkryetar, përgjigjen ti e jep prapë si donë vetë, pse nuk e more një herë mu konsultua me atë pronarin e kësaj kompanie, edhe e dinë saktësisht. Unë nuk mundem me ardh me incizua aty atë moment edhe me ta verifikua tye kështu me fakte. Unë tash, vetëm ishte çështja politike se ai ashtu nuk mujke me më lan pa qasje në rrugë. Se shumë shkurt edhe kjo, o ti zotëri, nuk ke të drejtë qytetareve me ja cenuar rrugën edhe kjo ka qenë krejt qëllimisht, ndërsa ti se the, ka pas aty

ingjinier, nuk ka pas, se ingjineri nëse ka pas kontroll prej komune si e kish pa qysh p.sh.: 4/5 shtëpive nuk i keni lan qasje në rrugë, por ai e ka bënë qëllimisht si më ka pa mua, për ata unë e ngrita si shqetësim.

z.Ekrem Abazi: Plotësisht pajtona me ty nënkryetar, se kriteret i kanë ligji, por sa po zbatohet ky ligj, por qeto gjatë pika që i thash pa i plotësuar nuk kalon askush, bile hala pa dal konkursi dihet kush ka me u punësua aty. Pak më herët e harrova edhe një punësohet edhe ai që bënë kërcënime ndaj juve a na që nuk dimi me bënë kërcënime na kurrë nuk punësohemi. Keni marr para dy vite a tri në gjuhën angleze, ka pas fakultet i gjuhës angleze për mësimdhënie dhe për përkthim, keni marr për përkthim e nuk keni marr për mësimdhënie që ka qenë.

z.Taulant Haxhiu: Faleminderit nënkryetar, unë i morra kontratat mbi vepër, por këtu ishin vetëm emrat dhe mbiemrat, këtu nuk e kam sa është dëmtuar buxheti i Vitisë edhe sa i kanë kushtua këta persona buxhetit të komunës. Për punën e autostradës, unë të kam përcjell nënkryetar, se ti aty na ke përfaqësuar të gjithë neve, por aty ma shumë Rexhep Kadriu bajke thirrje për protestë, kurse ti thojsh jo na nuk bëjmë protestë. Zoti nënkryetar, për punën e autostradës ne ta dinë edhe Pal Lekaj edhe Ramush Haradinaj, ne ta dinë edhe Rexhep Kadriu, se qysh po e ndreqin Dukagjinin, ai Gjilanin edhe Vitia duhet të ketë kyçje në autostradë, këtu duhet të gjithë me qenë bashkë, opozitë e pozitë. Në qoftëse nuk kryhen punët, beso që unë dhe të gjithë të tjerët të cilët me përkrahin mu, për interesa të qytetarëve, këtu nuk jemi për poenta politike, këtu është interes i qytetarit, të jemi se bashku, që nëse nuk i kryen Pal Lekaj dhe Rexhe Kadriu premtimet, qysh ju ka thanë juve në takim, na do të jemi protesta.

znj.Liridona Bislimi: Qyshe tha kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, nënkryetar, përgjigjet që po i jep po i thu sipas mënyrës tënde. E thash edhe në seancën e kaluar, i ngrita tri pyetje, ke për mbeturinat, pak me herët e pasni qit në wëp faqen e komunës, që jeni tu punu rreth kësaj çështje, jeni tu bënë përpjekje, ndërsa Vitinë e kanë kaplu mbeturinat, nuk pata kurnifara përgjigje. Familjen që e kemi vizitu ne, ajo ka mbet nën mëshirën e askujt, bile thuj kemi me i ndihmu apo jo, ceke. Tjetra, te nënkalimi, unë e thash, nënkalimi, ti i përmende vijat plus e sjelle përreth e shtinë edhe familjen time, është e vërtet e keni taku prindin tim, e dini ju se si e keni taku dhe për çfarë arsye e keni taku, ai e ka përmend që nuk keni bënë kurgja për Drobeshin, që pese vjet jeni ne qeveri, sa herë jeni nis për zgjedhje në fshatin Drobesh keni than hajde shkojmi, se atyre ja premtojmë nënkalimin dhe e kemi votën, tash aty është ndërtua një market, është bënë edhe me rrezik për fëmijët, kush do që i qon fëmijët me kalu rrugën nuk guxojnë me shku vet. Unë dy motra të mija që i kam, kanë pas aksident në atë rrugë, edhe prindi im e ka përmend, ka thanë le që nënkalimi nuk është kerka hiq, po edhe ato vijat që kanë qenë janë fshi, në atë kuptim e ka përmend. Banoret e fshatit Drobesh e kërkojnë nënkalimin.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Sejd, kerkushe nuk të tha që familjaret kem tu e qit diçka, unë thash eduakta familjare e dikujt ja jep konstruksioni qatë formë që nuk e ka fjalorin as si tani, për ata na jemi 36 a 30 apo sa jemi, gjithsecili e ka at konceptin e vet, në këtë kontekst ta thash, prandaj ti po ki qef me ik asaj. Asnjë çështje rreth asaj që kemi vendos këtu, që nuk e kam thanë, të gjitha i kam thanë, kam thanë edhe atëherë, po thamë edhe sot, me mban bindja, po se që unë me qenë në pozicionin e tyre, kur të thamë ka me shtru ka me bënë, prandaj nuk kam arsye me thanë, që ata nuk e bëjnë. Lidhet edhe me Taulantin, është mirë me i ndegju lajmet e jo me i shiku. Nuk e kam përjashtu protestën, kam thanë instancë e fundit, nuk ki arsye Rexhep Kadriut mi thanë, se kam qenë aty, ka qenë një lloj polemike, e ki në televizion, thotë kur u kanë kryeministri në fushatë, i thash që nuk u kanë fushatë, se jemi kanë bashkë me Beken aty, ka thanë ju protestoni, unë i kam than na nuk kemi nevojë me protestu kur ti je kryeministër, në këtë kuptim ja kam than, sepse kryeministri është shkallë e fundit e ekzekutivit, ai e ka çështjet në cilën mundet me vendos. Kam thanë protesta nuk përjashtohet në rast se i kalon afati atij zotnisë, i cili ka than ne Shtator unë e filloj, nuk e ka fillu në shtator, ka tha deri në realizim të kontratës kryesore të cilën e kemi me perfundu, e presim ata, tani i bëjmë hapat tjerë. Është mirë me thanë ashtu qyshe është thënë. Nijazi, po ta përsëris edhe njëherë, unë përgjigjet i jap qyshe janë edhe qysh është në etiken time. Kuvendi i Komunës nuk të bënë kyçje në rrugë, të bënë ekzekutivi, a e ki bënë naj kërkesë në adres të drejtorisë, apo organeve mbikëqyrëse, që mu për shkak bindjeve politike që po thua ti me kanë lan pa hy ne shpi. Me pas bënë kërkesë ti, me siguri ish kry brenda afatit sa me të shpejt. Liridona tha, nuk i morre pyetje, nuk muj mi marr se unë nuk kam informacio lidhje me at familjen të cilën ti e ki vizituar,

nuk do me thanë që unë jam në kabinet të kryetarit dhe po i njohim krejt familjet kush i ka punët mirë e kush keq. Unë habitem, sepse ti je aprovuese e buxhetit, unë jam propozues ti je aprovuese, a ki nda pare për ndërtim të shtëpive, jo, a po do me të rrejt unë a.

z.Sejdi Emini: Secili e ka bindjen e vet, jam me se i bindur që mu pas bë protesta para një viti, sot e kishim kyqjen, jam më se i bindur. Tash mue mundesh me më mashtru njëherë, të besoj njëherë, po herën e dyte e herën e tretë ja la fajin vetes që të besoj, po se di ju qyshe po mundeni me i besu kaq shumë, ku edhe kryeministri ka bë thirrje, dilni protestoni se është e drejt e juaja, e ti po i thu jo se po bëhem burrë i mirë.

z.Vehbi Rama: Përshëndetje, unë besoj se dikush lind septik, lind pesimist, dikush gjithmonë ka pesimizëm e dikush optimizëm, kryeministrin dikush e sheh vetëm ne televizion dhe i dëgjon deklaratat e tija, ndërsa unë para një jave jam taku me kryeministrin partisë së cilës edhe i takoj dhe kam bë këtë pyetje, ai ka than që do të ketë kyçje ne autostradë, për këtë është edhe kolegu im prezent, e kame kerku edhe ka qenë deputetja e Parlamentit të Kosovës, Donika Kada Bujupi, ka thanë, nëse nuk ka kyçje Vitia ne autostradë do të jep dorëheqje edhe Donika Kada Bujupi.

Drejtori z.Nexhmedin Jakupi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në këtë seancë! U ngrit si shqetësim nga këshilltarja Liridona, rreth mbeturinave, sidomos në pjese ne Viti, te poligoni, po e njoftoj asamblisten, se me 9 deri me 10 të këtij viti kemi largu dy deponitë ilegale që kanë qenë të krijuara aty dikun me një sipërfaqe prej 350 metra, i kemi pastru dikun 48 tonë mbeturina, i kemi qu ne Velekincë. Është e vërtet që edhe unë nuk pajtohem me këtë gjendje që e kemi me mbeturina, po vetëm po e përmendi një fakt dhe po e shfrytëzoj rastin prej asamblistëve me na ndimu ne aspektin e mbrojtjes së ambientit, pasi se vetëm institucionet nuk mujn me bë vet asgjë. Vet fakti se prej 11 mijë familjeve ose amvisrive në territorin e Komunës se Vitisë, vetëm 3500 qytetar paguajnë për mbeturina. Na nuk mujn me pas një ambient të pastër nëse nuk kyqmi në sistemin e menaxhimit të mbeturinave, nëse nuk paguajmë për shërbimet që e ofron kompania. Për momentin vetëm Debolleu, Devaja, Buzoviku dhe Letnica nuk ju ofron kompania shërbime, ndërsa lokaliteteve tjera ju ofron shërbime, mirëpo a jemi të kënaqur nuk jemi, ngase me një fshat p.sh.: me 500 familje, dikune 100 ose 150 janë në sistem edhe prej juve po kërkoj ndihmë që secili në mesin e vet të ndikoj tek qytetaret që ta kemi një ambient me të pastër.

Kryesuesi z.Naim Pira: Ju faleminderit për kontributin e dhënë rreth pyetjeve dhe propozimeve të dhëna jashtë rendit të ditës.

Për seancën e nëntë kemi paraparë këtë:

R e n d d i t e

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi procesverbalit nga mbledhja e dhjetë e Kuvendit Komunal të Vitisë.**
- 2. Propozim vendim Për shpalljen në diskutim publik të Rregullores për tatimin mbi pronën e paluajtshme për Vitin 2019**
- 3. Propozim Rregullore për mbledhjen dhe shpenzimet e të hyrave vetanake nga arsimit dhe aftësimi për të rritur.**
- 4. Informatë e buxhetimit të Përgjithshëm Gjinnor për vitin 2018 dhe planifikimi për vitin 2019.**
- 5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen Zonë me interes të përgjithshëm të ngastrat Kadastrale me nr. 153-0 në Zonën Kadastrake në Drobesh.**
- 6. Propoyim Vendim për ndryshim të vendimit Nr.01-410/03-71, të datës :08,02,2018 të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi**
- 7. Informatë nga Drejtoria Rini Sport Kulturë rreth AKV ‘Kemajl Azizi’ viti .**

A ka dikush rreth rendit të ditës ju lutëm: nëse nuk ka e kisha qit në votim rendin e ditës konstatoj se me vota unanime u miratua rendi i ditës.

Si pikë të par të rendit të ditës kemi:

1. Shqyrtimi dhe miratimi procesverbalit nga mbledhja e dhjetë e Kuvendit Komunal të Vitisë

Hapim debat rreth kësaj pike, a donë ta marr fjalën dikush ju lutëm?

z.Remzi Salihu: Nuk kam unë diçka të veçantë, por vetëm një nderhyrje këtu në procesverbal te fjalimi im i kaluar, te faqe 4, rreshti 16, ku thotë: “është kërkuar një parking pranë gjimnazit dhe më shumë të holla mund të ndërtohet”. Ky u dashtë me qenë me shumë pak të holla mund të ndërtohet.

Kryesuesi z.Naim Pira: A ka dikush tjetër rreth kësaj pike të rendit të ditës ju lutëm? Nëse nuk ka, me këtë përmirësim e qesim ne votim për miratim këtë pikë të rendit të ditës. Konstatoj se me vota unanime u miratua pika e parë e rendit të ditës.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi

2. Propozim vendim për shpalljen në diskutim publik të Rregullores për tatimin mbi pronën e paluajtshme për Vitin 2019

Ja kaloj fjalën përgjegjësit të kësaj drejtorie, pasi drejtori nuk qenka këtu.

z.Mufail Azizi: Ne kemi përgatitur draft rregulloren e tatimit në prone për vitin 2019. E veçanta e kësaj draft rregullore është, se prej vitit të ardhshëm do ta kemi edhe tatimin në tokë edhe një risi është që toka që punohet nuk tatimohet, nuk ka ndryshime tjera. Unë nuk kam qe me shtua diçka ma shumë, materialin e keni marrë me kohë, për ndonjë pyetje apo ndonjë sugjerim jam në dispozicion të përgjigjem.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës, a donë ta merr fjalën dikush ju lutëm?, nëse nuk ka, unë po e qes në votim për miratim. Kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës ju lutëm. Konstatoj se me vota unanime u miratua edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të tretë kemi:

3. Propozim Rregullore për mbledhjen dhe shpenzimet e të hyrave vetanake nga arsimi dhe aftësimi për të rritur

Është një rregullore që në vazhdimësi është kërkuar nga ana e stafit të shkollës profesionale, që të vie dhe të miratohet në Kuvend. Ne i kemi kaluar gjitha procedurat dhe e kemi sjell edhe një herë në kuvend, por sidoqoftë, nëse keni dikush mi i kontribua kësaj rregullore, unë po e hapi diskutimin.

z.Bekim Azizi. Rregullorja nuk ka pësuar ndonjë ndryshim prej inicimit që është bërë, megjithatë te neni 2, pika 4 e kam kërkuar edhe në komitet, kur thotë: “sipas kushteve të parapara, shkolla ka të drejtë ta bëjë rexhistrimin e një biznesi të vet me ligj”. Shkolla nuk ka drejtë. Edhe te çështja e pagesave, kisha kërkuar mësimi teorik dhe praktik paguhet 35% e pagesës e kandidatit paguhet për mësimdhënës. Një nxënës që e regjistron vitin jo formal paguan 150 euro rexhistrim, prej 150 eurove 13 mësimdhënës I marrin 35% të shumës, 18 javë duhet me shkua me dhanë mësim, kjo është pak. Unë mendoj se kjo duhet të bëhet 50% dhe pjesa tjetër ku institucionit edukativ shkollës që I shkojnë 55% të mbeten 40%. Unë mendoj se kjo përqindje duhet të përmirësohet, se është shumë e vogël.

Kryesuesi z.Naim Pira: Këto shuma që janë paraparë mos janë të rregulluara me ligj e ndoshta nuk kemi drejtë na mi ndryshuar. Nëse nuk janë, kuvendi ka të drejtë me marr vendim mi ndryshuar.

znj.Mirlinda Sadiku: Pajtoj me kolegun Bekim, pikërisht kjo është vërejtje që ka dhanë LVV në leximin e parë, megjithatë unë e di drejtoresh se nuk vjen nga ju, por vjen nga drejtori i shkollës.

Te neni 3, keni thanë dhënia me qira e hapësirave shkollore. Do të thotë klubet sportive private nëse paguajnë ato kanë me pas qasje në sallë, mirëpo e them me kompetencë të plotë, dëmet që janë bërë sidomos këto dy vitet e fundit janë shumë të konsiderueshme, d.m.th. kur ja paguan ti me pare duhesh të ja lëshosh ti terminin. Kush do të përkujdeset, kush do ta mirëmbaj atë hapësirë, drejtoresh. Edhe një pyetje tjetër, nuk e di a e keni konsultuar Zyrën Ligjore, i referona neni 4, ku këtu thotë: “se institucionet edukativo arsimore aftësuese lejohet deri 50% gjysmën e orarit të punës”. Mirëpo, sipas kontratës kolektive, neni 11, thotë: “mësimdhënësit gëzojnë të drejtën për punë mbi normë të paguar deri në 30% të ngarkesës mësimore”, d.m.th. nuk lejohet më shumë se 30%. Mos po bie ndesh me këtë kontratë, sepse këtu është thanë 50%. Po ashtu do të dal aty ku e ceku kolegu parafolësi Bekimi, sepse me këtë rregullore askush nuk e njeh në thelb apo në distancë sa e njohim, unë edhe Bekimi edhe kolegët tjerë që japim mësim jo formal te shkolla jonë, unë kam diskutuar edhe me disa kolegë te shkolla profesionale, ku disa prej profesorëve bëjnë pjesë edhe në këshillin e shkollës, se shuma prej 35% është një shumë e vogël, tu e llogaritë që shkolla jonë nuk ka zëvendës drejtor, kur i shtohet edhe ky 2%, d.m.th totali që i mbetet shkollës është 57%. Ta bëjmë një përlllogaritje të thjeshtë, për me pas ma të qartë edhe kolegët e nderuar. Po ashtu edhe nënkryetari, nëse shuma për një gjashtëmujorësh ka kandidatë, shuma e përgjithshme është 3000 euro. Të ardhurat të cilat i mbesin shkollës me përqindjen edhe të zv drejtorit është 1710 euro, ndërsa për mësimdhënës është 1050 euro, kur të pjesëtohet me numrin 13, që janë 13 mësimdhënës që japin mësim. A e dini cila është shuma, 80 euro, plus me rregullore kujdestari i klasës për arsye se ka ngarkesë administrative ka pune të shumta, për mbushje të diplomave, certifikata, plus ka edhe praktiken profesionale, ai paguhet me shumë se profesorët të tjerë. Kur të ja hekmi kësaj shume përafërsish 30, Beka tha 20 euro nëse nuk gabo, d.m.th për 30 euro profesorët do të jenë mëdyshje a ta mbajnë apo mos ta mbajnë mësimin jo formal. Nuk e di a jam e qartë drejtoresh. Po ashtu këtu kur të ja shtojmë edhe tatimin në të ardhura, që e cek neni 5, nën shkronjën h, obligimet ligjore, se edhe këto para tatimohen, d.m.th shuma bjen hala më poshtë. Si dhe drejtoresh kisha një pyetje, neni 9, te auditimi, nëse ki mundësi me na dhënë përgjigje i referohem pikës 2 këshilli i shkollës apo struktura e ngjashme me të në bazë të kompetencave të ti ka të drejt që të ngrit një komision për kontroll financiar të institucionit. Me sa e di unë, vetëm kryetari mund ta autorizon Njësinë e Auditimit të Brendshëm të bej një kontroll financiar. A mundesh me naj dhënë një përgjigje, si dhe neni 9, pika 4, për mu një fjali këtu është e pakuptimtë. Secili prej strukturave përkatëse të auditorëve mund të rekomandon ose të propozon struktura përkatëse udhëheqëse. Këshilli i Shkollës apo sekretari i për hershem ne MASH për marrjen e masave adekuate në përputhje me shkallen e lëndimit të detyrave të punës. Për mu kjo nuk është e kuart nëse mundesh me naj shpjegu me tutje këtë.

z.Ali Bajrami: U ceken nga parafolësit të cilët janë direkt të kyçur në këtë proces mësimorë. Si propozim rregullore një kohe të gjatë është kërku dhe ne fund është punu pikërisht prej stafit, prej strukturës së brendshme profesionale. Më vjen shumë keq që këto çështje nuk të kokan diskutu brenda, po tani këtu po i ngritni. Unë kam besu që kjo rregullore është analizu, është diskutu dhe nuk e kam prit prej juve këto vërejtje tani. Nëse këto që janë cek në rregullore janë në harmoni me ligjet e MASH-it, a kemi ne si kuvend komunal të drejt ligjore të bëjmë ndërhyrje dhe ti ndryshojmë. Nuk ka kurrkush asgjë kundër asaj për punën që behet me u shpërblye me at punë, po nëse nuk kemi të drejt mos po bimë ndesh me ligjin, po e marrmi najë vendim që është në kundërshtim me ligjin me naj kthy MAPL-ja.

z.Bekim Azizi: Po kyçem tek z.Ali Bajrami. Nuk është çështje të vërejtjet e rregullores, pjesa tjetër edhe auditimi janë me ligjin që menaxhojnë të hyrat vetanake, janë me ligj të caktuara këto. Edhe unë mendoj që këto nuk muj me i ndërru se janë me ligj caktuara. Kështu unë vetëm konkretisht kërkova, ka mujt ndoshta me u bë, janë pështjellim që shkolla me bë biznes. Unë po kërkoj që nëse ka të drejt shkolla me regjistru biznes, e lami, nëse nuk ka të drejtë e hekmi, këtë e kërkova unë dhe kërkova mu ndërru koeficienti 50% me dal të mësimdhënësit dhe mu zvoglu ajo çka i bjen shkollës prej 55 plus 2% qe është të zv. drejtori me kalu 40% ajo, këtë e kërkova.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Me qenë të sinqertë, Mirlinda e ngiti një çështje shume me rendësi, kontratën kolektive të cilën e kam lexu, po qat nenin që e thave ti që është mbi norma dikun 30% e lejueshme, po kjo nuk ka të bej me mësimin jo formal, nuk ma merr mendja mu që ka të bej me mësimin jo formal, po në kuadër të mësimin të rregullt, ndërsa propozimi i Bekimi tek 50% mu nuk me bën përshtypje ajo çështje, ju e dini më mirë se sa duhet të jetë ajo dhe cili do të jetë interesi i mësimdhënësve për me majtë atë mësim, se interesi i nxënësve është, se ata paguajë njëjtë, prandaj është mirë me dal me propozim konkret dhe at çështjen se a ka të drejtë shkolla me pas të regjistruar një biznes e birësojmë, ndërsa at që u tha nuk jam me e hek çështjen e dhënies me qira. Çështja e dhënies së sallës me qira, përderisa nuk e kemi të kompletume palestrën e sporteve, konsideroj ne e kemi një ekipë të basketbollit, po nuk duhet me ju dhënë në kohën e orarit mësimor.

Drejtoresha znj.Fatbardha Emini: Zyra Ligjore po besoj që e ka harmonizu këtë rregullore konform dispozitave ligjore dhe kjo rregullore rregullon vetëm organizimin e mësimin jo formal. Krejt çka diskutohet këtu ne këtë rregullore, ka të bëjë me organizimin e mësimin formal, për pagesën nuk rregullohet. te çështja e auditimit, e dimi që raporti i këshillit drejtues të shkollës është me udhëzim i rregulluar edhe për aspektin financiar është këshilli drejtues i shkollës që e monitoron drejtorin e shkollës. Sa i perkës shpenzimeve financiare, është e vërtet që për momentin shkollat nuk janë të regjistruar, po është duke u punuar udhëzimi administrativ që e kane shkollat profesionale, bizneset, muj me shti diçka, kjo ka qen ideja e drejtorit, që këta nesër me regjistru biznesin, po për momentin nuk ju njihet.

Kryesuesi z.Naim Pira: Meqenëse udhëzimi administrativ të koka në punim e sipër, ne nuk muj marrmi vendime akoma pa ardh drafti final. Ne këtu po propozojmë që të terjeket kjo pikë dhe me naj seancë tjetër e plotësojmë. Atëherë te neni 2, pika 4, heket krejt dhe ajo pjesa që ishte nga 35% kalon në 50% me propozim të Bekimit. Atëherë jam i obliguar me qitë me këtë propozim të cilët ju e dhatë. Konstatoj se me vota unanime u miratua edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të katërt të rendit të ditës kemi:

4. **Informatë e buxhetimit të Përgjithshëm Gjinator për vitin 2018 dhe planifikimi për vitin 2019.**

Ftoj ta merr fjalën përgjegjësi i kësaj pike.

z.Berat Zuka. Me pranimin e vendimit të kryetarit të komunës për përgatitjen e një materiali si një dokument si ta quajmë apo raport për barazi gjinore, ne si komision në mbështetje të OSBE se dhe në mbështetje të drejtoreshave e kemi përgatitur edhe e kemi sjell sot për diskutim. Unë ma shumë nuk kisha me ju marr kohë, pasi materialin e keni pranuar me kohë, nëse është dikush për ndonjë pyetje apo ndonjë sugjerim jam në dispozicion të ju përgjigjem.

Kryesuesi z.Naim Pira: Faleminderit Berat. Hapim debat rrethe kësaj pike të rendit të ditës, a donë ta merr fjalën dikush ju lutem.

znj. Gjylsime Qamili: Përshëndetje për grupin punues, OSB-en, drejtoritë përkatëse të cilët dhanë ndihmë rreth këtij dokumenti, i cili dokument për here të parë doli para nesh Informatë e Buxhetimit të Përgjithshëm Gjinator për vitin 2018 dhe planifikimi për vitin e ardhshëm, ku unë lirisht mund ta quaj një dokument bazë për planifikim buxhetor, në të cilin dokument janë të paraqitura edhe objektivat, aktivitetet, indikatorët, ku veç shifet një pasqyrim real I punës të cilat të dhëna do të nevojiten për planifikim të buxhetit për vitin 2019. Kjo mund të shpije drejt një barazie të përgjegjshme ekonomike, politike dhe sociale, duke siguruar se gratë, burrat, vajzat dhe djemtë përfitojnë në mënyrë të barabartë nga fondet publike. Krejt në fund grupet punuese, Zyrës së Kryetarit dhe drejtorive përkatëse ju uroj punë të mbar në vazhdimësi.

znj.Mirlinda Sadiku: Ashtu qyshe e tha edhe kryesuesi, d.m.th Kamenica ka qenë kishtarë, ajo që e ka fillu me buxhetimin e përgjegjshëm gjinore, ani pse qysh në vitin 2014 buxhetimi gjinor është prezentu ne qarkoren buxhetore 2015/01 e publikuara nga Ministria e Financave, ku shumë kjart thuhet që aty kërkohet transparencë, llogaridhënie, efikasitet, prosperitet dhe mbi të gjitha barazi. Shumë mirë që më në fund edhe Vitia e ka një raport analitik për buxhetimin e përgjegjshëm

gjinor, ku të dëgjimet e buxhetit komunal është kërkuar një gjë e tillë, pikërisht jam unë ajo që jam mundu me shty përpara një gjë të tillë. Nëse shikohet si shifra ne perspektivën gjinore, shifrat flasin vet gjithsej prej 1153 punonjësve 694 janë burra 486 gra a po shprehur në përqindje 58% burra dhe 41% femra. Dy drejtoritë ku vërehen thellësisht pabarazia gjinore, janë Drejtoria e Inspeksionit, asnjë femër, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe po ashtu e kemi drejtori e shërbimeve sociale, d.m.th ne këto nuk ka femra ne Drejtorinë e Urbanizmit, vetëm një femër dhe në Drejtori të Gjeodezisë vetëm një edhe pse kisha pas qef se kryetari ka pas premtu 40% mi pas drejtoresha në ekzekutiv sikur që te merrmi shembuj të mirë nga komunat e tjera, mirëpo deri me sot i kemi vetëm dy femra drejtoresha. Ajo çfarë është shqetësuese për mu është, se nëse i behet një analizë e mirëfilltë shifrave që nga vitit 2013, ka vazhdimësi të rënies së bizneseve te udhëhequra nga femrat, ku përderisa në vitin 2013 kanë qenë 30 biznese të regjistruara që udhëhiqeshin nga femrat ne vitin 2018 janë 17 biznese, d.m.th ka një ramje e sipër. Ne e dimë që pavarësia ekonomike mundëson edhe avancimin e një shoqërie përpara. Shpresoj që objektivat e paraqitura, sidomos te Drejtoria e Bujqësisë të realizohen me punë, me subvencione, me përkrahje, sepse në ndarjen e subvencioneve, aty komuna mund ta vendos theksin dhe mund të bënë ndarje të drejtë tek përfituesit, sidomos asaj gjinie femërore te makineritë bujqësore, bimë mjekësore, aromatike. Ju është premtu sistemi pikë pikë, shpresojmë që do të realizohet si dhe përkrahja e femrave për trashëgimin bujqësore, ku në nivel vendi prinë Ferizaji me 820 prona të regjistruara. Ajo çka me ra ne sy vazhdimësi drejtor, tek DKA-ja ku numri I braktisjes se nxënësve të shkollave është zero. Këto shifra nuk janë të sakta, unë I kontestoj me plotë të drejtë, sepse unë vij nga ajo fushë e arsimit dhe çdo ditë jemi dëshmitar, se ka një numër si nga gjinia femërore po edhe nga ajo mashkullore që e kane braktis shkollën. Po ashtu vitin e kaluar kishmi rastin me fëmijët nga fshati Debulde, që për shkak që nuk ju mundësua pagesa e transportit, shume prej tyre edhe e kanë humb vitin, d.m.th u paraqit edhe si objektivë. Thashtë Zoti të funksionon të ardhmen dhe ta keni parasysh, sepse numri është, çdo ditë kemi braktisje të shkollës, sidomos nga zotat e thella rurale, Debuldehu dhe Letnica. Kishmi rast edhe nga gjinia femëror, po sidomos nga gjinia mashkullore, po kur ka një distancë prej 14 km, për gjininë femërore është me sfiduese për me ardh deri te shkolla e mesme profesionale ne Viti ose te “Kuvendi i Lezhës”.

znj.Liridona Bislimi: Sa i përket raporti analitik të buxhetimit të përgjithshëm gjinore për vitin 2018, i cili është formuar sipas Ligjit për Barazi Gjinore dhe qarkores buxhetore, sipas këtij raporti na del se ne komunën tonë i kemi 49.55% femra ndërsa meshkuj janë 50.45%, nuk ka shume dallim në mese tyre, por gjatë punësimit që i kemi këtu, ka shume dallime. Zyra e Kryetarit të Komunës ka punësuar 36 persona, prej tyre 30 meshkuj, vetëm 6 femra; Drejtoria për Administratë dhe Personel, prej 35 personave, vetëm 5 janë femra; Drejtoria për Financa, prej 26 punëtorëve, 3 prej tyre janë femra; Drejtoria e Inspeksionit, të gjithë meshkuj asnjë femër; Drejtoria e Shërbimeve Publike, të gjithë meshkuj asnjë femër; Drejtoria për Bujqësi, 14 punëtor, 12 meshkuj e 2 femra; Zyra për Komunitete, 3 persona që të tretë janë meshkuj; Drejtoria për Kadastër, 9 persona, prej tyre 1 femër; Drejtoria për Urbanizëm, 4 burra të punësuar e 1 grua; Qendra për Shërbime Sociale, 10 persona, të gjithë janë meshkuj; Drejtoria për Kulturë, 14 punëtor, 10 meshkuj e 4 femra; Drejtoria për Shërbime Publike, Sociale, 139 persona, 52 meshkuj, 87 femra; Drejtoria për Arsim, 818 persona, 449 burra, 369 femra. Përfaqësimi i femrave në Komunën e Vitisë është ende i vogël. Unë kam mendua që ta formojmë një Komitet për Barazi Gjinore. E di që është komitet i formuar, mirëpo në bazë këtij komiteti, nuk është funksional. Unë e kame përcjell komunat tjera, e kemi Komunën e Malishevës dhe Komunën e Gjilanit, ku ky komitet është shume funksional dhe në bazë tyre ka ndryshime në Administratë tu fillu nga drejtoritë.

z.Bekim Azizi: Kjo është një informatë, nuk është një informatë që muj ma me diskutu që me e ndryshu shume, kjo është një e mirë që naj kanë sjell me pa ne gjendjen si është këtu. Krejt ne këtë informatë që e kemi, e kemi sa merr rroga gjinia mashkullore sa ajo femërore. Nëse përmendet aspekti gjinor, nuk është që duhet me diskutu për gjininë femërore na, si të përmendet gjinia, krejt me diskutu për gjini femërore, nuk ka mundësi kjo. Nuk është që duhet aspekti gjinore i ka dy

gjini, investimet kapitale që behën për dy gjinitë, çdo sen që investohet behet për dy gjinitë. A janë shqetësuese që ndoshta nuk ka do vende, është normale, po na shumar sun qojna femër ose ne kuvend, pse nuk jemi barabar, pse nuk po i fiton votat, po duhet në shume vendi shteti jo i ka rezervu me ligj që duhet me pas përfaqësim, sepse hala është mentaliteti i shoqërisë tonë, dijet si ka shku, ose shkollimi ka qenë me i vogël i femrave se sa i meshkujve. Kanë qenë shumë faktor, na duhet me thanë që unë mendoj me bë një konkluzion këtu, që na duhet të mundohemi që ta bëjmë një balancim ose ti japim hapësirë më shumë në kushtet e barabarta të avancohen femrat, përndryshe kjo informatë tregon gjendjen që është në institucionet tona. Unë jam qe në kushtet e barabarta duhet me ju dhënë përparësi femrave.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka të tjerë për me diskutua, unë po ju falënderoj të gjithëve, gjithashtu i falënderoj edhe grupet punuese që naj kanë sjellë një informatë të tillë.

Si pikë të pestë të rendi të ditës kemi:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen Zonë me interes të përgjithshëm të ngastrat Kadastrale me nr. 153-0 në Zonën Kadastrake në Drobesh

Drejtoresha znj.Majlinda Ostrogllava: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi vjen me këtë propozim vendim, ku propozon të shpalljen Zonë me interes të përgjithshëm, pjesa e ngastres kadastrale numër 70101021-00153-1, në sipërfaqe prej 137 m² ne vendin e quajtur “Bregu Jaruga” ne zonën kadastrale ne Drobesh, e cila është në pronësi të Azem Bislimit nga fsh Drobesh Komuna e Vitisë, nga stra kadastrale e shpallur zone me interes të përgjithshëm si në piken nga neni 1 i këtij propozim vendimi në zonën kadastrale në Drobesh, do të shfrytëzohet me qellim të interesin publik. Projektet e zhvillimit të Komunës së Vitisë për zbatimin e këtij propozim vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi; Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente; Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Vitisë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Remzi Salihu: Faleminderit drejtoresh për shpjegimin që naj dhave, po megjithatë me atë shpjegim që naj dhatë ju, unë nuk kam mujt ta akceptoj sa duhet. Kërkoj një shpjegim me të hollësishëm, se për çfarë bëhet fjalë, për çfarë interesi të përgjithshëm dhe çka parashihet të përdoret ajo parcelë e cila nënvizohet apo ceket ne këtë propozim vendim. Kam shiku unë te sipërfaqja që të Njësia kadastrale 153-01 kam parë që sipërfaqja që është këtu me sipërfaqen që është në fillim me metra katror, nuk përputhet. Tash a duhet kjo sipërfaqe që të ndahet nga kjo 237 m² që të ndahen nga kjo që është e dhënë nga ju, apo si është puna, sepse këtu keni 853m² dhe kjo që përmenda nuk figurohet. Një sqarim me detalisht edhe e kam kërkuar edhe atje ne gjeoportat, kam pa atë parcelën e cila është ne fjalë, po d.m.th nga ajo që na ka ardh neve këtu në kopje, shihet fare pak aty që ka apo nuk ka objekte, megjithatë aty ishin disa objekte që nuk korrespondonin bash me parcelën, disa ishin me një parcelë tjetër e disa në këtë që behet fjalë. Një sqarim pak me të detal, konkret, për çfarë destinacioni bëhet fjalë.

Drejtoresha znj.Majlinda Ostrogllava: Këtu është që të behet këmbim I parcelës, d.m.th prej pronës private dhe publike. D.m.th këtu e ki skicën, prona publike është kjo me ngjyrë të pemët dhe këto me ngjyrë të verdhë janë prona private. Këtu bëhet këmbimi, 123m² i jepen pronës private, 237m² i merren pronës private. Këtu nuk ka kurgja të keqe, këtu gjendja faktike ekziston, rruga është, vetëm gjendja juridike na duhet, nuk ka asgjë të keqe, vetëm këmbimi i pronës, prapë kjo do të vjen në kuvend.

Kryesuesi z.Naim Pira: Ne edhe në mandatin e kaluar kemi pas provoja të tilla. Me sa kamë unë informacione, kjo pjesë e zonës është për pronën private, dhe tash është bë nga ana e pronarit një kërkesë, që të behet shkëmbimi i kësaj prone në mënyrë që qajo pjesë e cila bjen në pronën

private të dislokoheh në pronën publike dhe ajo pjesa tjetër të merret, nuk ka kurgja të keq këtu të behet këmbimi.

z.Remzi Salihu: Faleminderit drejtoresh, po, po më duket që këtu është marr praktik me votu na diçka që nuk e dimi, prandaj nëse ne do të kishim votu në atë mënyrë qysh e kemi atje, unë besoj që do të kishim bë shkelje ligjore, sepse do kishim votu për diçka që ne nuk e kemi ditë. Unë falënderoj pronarin që ka shpreh vullnet të mirë të bëjë një këmbim, dhe pikërisht te gjendet zgjidhja, po këto gjera u kanë dashtë me naj shpjegu neve, sepse unë atje kur e beja krahasimin, nuk me dalshin kerkun hiq, as shifrat, as vendi, as distanconi, prandaj e kërkova sqarimin.

z.Nijazi Isaku: Çështja që u ngri nga asamblistët tjerë ke problem. Na sipas këtij propozim vendimit, është për shpalljen zonë në interes të përgjithshëm, por tash prej drejtoreshe na dul që ajo është edhe ndërrim I pronës private. Këtu kur të behet propozim vendimi, ka qenë dashur të ceket në propozim vendim, që ka mu ndërru edhe parcela. Tash qysh është kjo formë si procedurë, ju ndoshta e dini më mirë, mirëpo me qet propozim vendim na e kemi vetëm për shpalljen me interes të përgjithshëm, atëherë është në kundërshtim nëse është zonë për shpalljen me interes të përgjithshëm, ku ne anën tjetër paska edhe këmbim në aspekti privat. Si emërtim duhet mu ndryshu ky propozim vendim, nëse e shpallim zonë me interes të përgjithshëm, po ama ne nuk po dakordohemi me qeta, po e bëjmë këmbimin me çështje private, se këtu në propozim vendim thotë kështu. Po dakordohemi që nëse me qet propozim vendim shpalljen e zonës në interes të përgjithshëm, kjo është vetëm për shpallje të zonës me interes të përgjithshëm, po jo edhe për këmbim të pronës.

Drejtoresha znj. Majlinda Ostroglava: Nijazi, tash jemi tu e votu vetëm propozim vendimin, pëlqimi paraprak prapë do të vjen për Ligjin për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të komunës, prapë për këmbim të pronës ka me u votu.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, po e qes në votim për miratim. Kush është që të miratohet ky propozim vendim? Nëse duhet me ardh prapë në kuvend, ne sigurisht që do ta sjellim prapë, kush është që të votohet ky propozim vendim? Konstatoj që me votat e përgjithshme u miratu edhe kjo pikë e rendi të ditës.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

6. Propozim Vendim për ndryshim të vendimit Nr.01-410/03-71, të datës 08.02.2018 të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Bazë udhëzimit administrativë me të cilët caktohen anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, të gjithë shkojnë sipas detyrës zyrtare dhe në momentin e themelimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, kemi pas të formuar këshillat e prindërve në nivel të shkollave, po këshill të prindërve në nivel komunal nuk kemi pas, prandaj na e kemi marr një anëtar nga shkolla e mesme “Januz Zejnullahu”, ka qenë anëtar i KKSB-se dhe tash para një muaje është themelimi i këshilli I prindërve në nivel komunal dhe është zgjedh Avdyl Misini. Prandaj bazë udhëzimit administrative duhet të jetë ai anëtarë. Unë kam prit deri sa e kam mbajt një mbledhje të KKSB-së, e kame ulë atë zotnin aty dhe I kam shpjegu, që në momentin që formohet këshilli I prindërve në nivel komunal, e kryetari I këshillit të prindërve në nivel komunal duhet me qenë anëtarë I KKSB-së.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë. Pasi që nuk ka për diskutim e qes në votim për miratim. Konstatoj që me votat e përgjithshme u miratu edhe ky propozim vendim.

Si pikë të fundit të shtatë kemi:

7. Informatë nga Drejtoria për Rini, Sport dhe Kulturë, rreth AKV “Kemajl Azizi” Viti

Kjo pike ka ardh me kërkesën e z.Bekim Azizit, fjalën ja kaloj drejtorit.

Drejtori z.Milot Lala: Faleminderit kryesues, përshëndetje të nderuar të pranishëm! Në mbledhjen e fundit të KPF-së, grupi parlamentar i PDK-së ka kërkuar që në seancën e sotme të sjellim informatën rreth ansamblit “Kemajl Azizi”. Besoj që materialin e keni marr të gjithë, ku

kam paraqitur informatë të shkruar, ku e kam paraqit historikun e asambelit dhe gjendja e tanishme. Jo rastësisht e kemi paraqit historikun, duke pas parasysh sfidat, sakrificat dhe përpjekjet për tu arritur në majet me të larta të suksesi, ku sot është I vetmi ansambël në Kosovë që mbështetet me vendim të kuvendit komunal nga buxheti I Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport me 25% të buxhetit, dhe padyshim është një nga ambasadorët me të mirë të komunës tonë. Materialin e keni marr me kohë, për pyetje dhe përgjigje jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë.

z.Bekim Azizi: Tu e pa një kohë që ka problem të shoqëria kulturore artistike “Kemajl Azizi” dhe kemi paraqitur shqetësimin tonë, për shkak të mosfunksionimit të tij, sa e kuptova nga drejtori, aty kanë fillu mu shty kush me marr shoqërinë, kush me e udhëheq, drejtori nuk na dul në fund me diçka, po vetëm e paraqiti gjendjen e cila është. Informatën që e kam kërku unë, që pajtohem dhe e dimë që ka shkresa edhe nga Zyra Ligjore, i kam pa edhe prej ministrisë. Na jemi tu diskutu këtu, e dimë që OJQ-ja është e ndame prej pushteti, po ne po diskutojmë këtu, sepse kjo shoqëri subvencionohet nga komuna, d.m.th 25% janë pjese që ndahen, dhe në momentin që ju ndahen ato duhet edhe të ketë një mbikëqyrje për ato mjete ku shkojnë, qysh shkoj dhe apo funksionon kjo shoqëri, pasi që është nën ombrellën e menaxhimit të komunës. Unë mendoj, na duhet sot të bisedojmë, pak a shume ta orientojmë çka duhet të behet këtu. Nuk kam dal sot që të shkojmë deri në vendim të subvencioneve, na e dimë që Vitia ka nevojë për shoqërinë, na e dimë që ka nevojë Vitia për programe, mirëpo unë mendoj si kuvend që jemi, kisha pas qef me dal me propozim. Unë pasi që e kam kërku këtë informatë, që të respektohet statute i OJQ-së “Kemajl Azizi” dhe të ja japim një afat kohor na si kuvend dhe unë kisha mendu, që ky afat kohor të jete deri me 31 Janar, që për dy muaj shoqëria t’i zgjedh problemet. Shoqëria të funksionoj zyrtarisht, pa ndërhyrje politike mundësisht, se shume dyshoj, se nashta është ndërhyrje politike mbas sa vite e kan pru këtë gjendje shoqërinë, mirëpo nuk kisha pas qef të ketë ndërhyrje politike, po ata të ulen si njerëz, kanë funksionu që një kohe të gjatë, kanë bërë punë të madhe që një kohë të gjatë. Kjo shoqëri ja ka zbardh fytyrën komunës ku ka prezantuar, besoj se dy muaj afat, a forma e kuvendi apo si zgjidhen ata le ta bëjnë një zgjedhje të mirë, që shoqëria të jetë stabile. Ky është mendimi im dhe për këtë kohë kisha kërku, deri sa ti zgjidhen problemet asnjë subvencion, asnjë cent mos të ju jepet prej komunës, nuk ka nevojë me ju dhënë një cent në këtë formë, përderisa nuk janë tu funksionu. Nuk e kemi obligim me ja dhënë 25%, e këta mos me be asgjë, e këta mos me dal në program për 28 Nëntorin, këta e kanë obligim festat çka janë të parapamë në Statutin e Komunës me ardh edhe me prezentu, e kanë obligim, sepse në kuadër të asaj është marr edhe vendimi me ju nda mjete. Këto problem të zgjedhin, mendoj në këto dy muaj nëse nuk i zgjidhin për dy muaj nga 1 shkurti unë do ta inicioj vendimi për me ju ndal këto mjete.

z.Taulant Haxhiu: E dimë që shoqëria “Kemajl Azizi” është një nder shoqëritë me progresive në Komunën e Vitisë e cila vazhdon aktivitetin e saj që 20 vjet kja ka qen ambasadori me I mirë për ne qytetaret e Komunës së Vitisë, por tash kohen e fundit edhe kjo po do mu kap po me doket nga pushteti siç veprojnë kryetari i Komunës z.Sokol Haliti me klubin futbollistit “Vitia”, vetëm tash janë tu e udhëheq servilet e tij, na këtë e dimë të gjithë, ishalla nuk e ka kap edhe këtë, na po e shohim që këtu nuk kemi kryetar siç është Sokol Haliti, kryetari I demokracisë, media nuk kemi, që gjashtë muaj ditë na ndal edhe media, TV plusi sot ka ardh në baza vullnetare. Unë Sokol Halitit, në bazë që po I kap të gjithë segmentet e Komunës së Vitisë nuk muj me quaj lider të demokracisë ose kryetar të demokracisë, le ta din të gjithë qytetaret e Komunës së Vitisë, se ai e ka një emër ai Kim YoungIn i Komunës së Vitisë, ai I ka prish të gjitha institucionet qeveritare dhe joqeveritare, po në qoftëse dikush do të bëjë replikë me këtë atëherë kam argumente. Lus prej shoqërisë “Kemajl Azizi” dhe udhëheqësve të tyre, që të merren vesh që të konsultohet edhe z.Hetemi edhe z.Zenunu, të cilët kanë qenë bashkë disa vite, edhe z.Rexhepi që është sot prezent këtu, të ketë shoqëria progresin qyshe I ka pas me herët, mos të behet naj farë siç po e shoh veç shoqëria ka ardh me një farë përfundimi, që të vihet në përfundim dhe ta përkrahim propozimin e Bekes, të ju ndalen edhe subvencionet nëse nuk merren vesh këta deri në kohen kur tha kryetari I

partisë sime, deri ne kohen e caktuar, atëherë besoni që do ta qesim ne votim dhe do të ju ndalen edhe ato subvencione të cilat I keni ne si qytetar. Unë si një qytetar i viti, i cili i njoft të gjithë ansamblin “Kemajl Azizi”, nuk e di pse ka ardh deri të ky konflikt kur është zgjedh kryetari I shoqërisë, apo drejtori, Adnan Zenuni dhe ky tjetri që e ka pru deri këtu situatën z.Hetemi e ka votu edhe e ka nënshkru që e ka pranë Adnan Zenuni për kryetar te “Kemajl Azizi”. Atëherë bisedoni, ndani ne mese veti përgjegjësi që te vazhdon “Kemajl Azizi” aty ku e keni lan, të jetë në progres të vazhdueshëm. Për ndryshe do të veprojmë siç e tha Bekimi.

z.Nijazi Isaku: Informata na edhe vetëm sot ne seancë fatkeqësisht, na as nuk e kemi pas këtë informatë. nuk du mu nderlidh shume ne kuptimi që drejtori e shpjegoj ecurinë e vendimeve dhe shkresave zyrtare që kanë ndodhe. sa I parket “Kemajl Azizi”, pak a shume dakordohem që është prej shoqërive që I ka dhënë shume viti dhe I jep, po fatkeqësisht tek ta ka ndodhe një shtyrje, po me duket siç po shihet ne mes të kryetarit te shoqatës nuk e di se sa na si kuvend muj me e obligu, kur edhe me ligj OJQ-ta janë të pavarura. Na si kuvend e kemi një vendim që I kemi nda subvencione 25% kësaj shoqërie, ne vetëm ne këtë rrjedhoj majme me diskutu si kuvend, po nuk muj me nxerr propozime ne formë këshilluese, që I kërkojmë nga Kuvendi Komunal që me zgjedh problemin vet, kur ata si shoqëri kanë një statut, që ne bazë te statutit ato veprojnë. Po tash kush e mbikëqyrë atë statut, besoj që është ne kuadër të ministrisë së caktuar, po edhe bazë asaj shkrese që ja ka kthi ministria, krejt është ne vullnetin e OJQ-se si I zgjedhe organet ekzekutive të saj. Unë po thamë me gjet naj module me të mirë që me bë një zgjedhje ata.

z.Ali Bajrami: Krejt këto paraqitje po I bëjmë me qëllimin me të mirë, për me dal prej kësaj gjendje, po për mu është e pakuptimtë me dhënë afate kohore, kur themelues I shoqërisë kulturo-artistike “Kemajl Azizi” nuk është Kuvendi I Vitisë, po është e regjistruar si OJQ, po me I ndihmu po me I përkrah, po I kemi përkrah deri tash edhe do t’i përkrahim, po në at kuptim me ju dhenë ndimes me I zgjedh problemet që I kanë, për momentin besoj që do ti zgjidhin dhe do t’ tejkalojnë, ne rend të parë tu nis nga ajo nëse e qesin ne ren të parë funksionimin e ansamblit, e jo interesat personale. Nëse hinë ne interesa personale, problematika do të vjen duke u rrit, por ajo çka është esenciale, të ju ndihmojmë të gjithë me qëllimin me të mirë. Politika ndikimin e ka minimal edhe këtu do ta ketë, dhe të vijmë të një zgjidhje, le të vazhdon aktiviteti, funksionalizimi në mënyrën me të mirë, se na e dimë reprezentimin që naj ka bë si shoqëri në nivel të vendit dhe jashtë vendit si shoqëri kulturore artistike. Prandaj afatet kohore, unë jam po çka nëse nuk respektohet ai afat kohorë, unë besoj që kanë me tejkalu këtë problem dhe do të vazhdoj funksionimi I ansamblit.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Taulant, po të thamë ne aspektin institucional e shoqëror, është e met e një këshilltari komunal me prolongu njerëz të cilët nuk janë këtu, është shume e mete e individit edhe me than se politika që e di, po jam kanë I kyqur 100% rreth zgjidhjes institucionale të aspektit të kërkesës që e kanë bë ne aspekti ligjor dhe që Zyra Ligjore mu ka drejtu mu, I kam than pasi që ata dytë janë që kanë kontribu, edhe ish kryetari edhe ky qe është zgjedh, drejtoja lenden ministrisë, ministria nuk është Sokol Halit, prandaj këtu është ajo çështja. Tu kisha lut mu rujt prej këtyre, e ka marr edhe klubin, po se ka marr as klubin e as shoqërinë po me i ndihmu i ka ndimu, se është kryetar I Komunës, sikur se një kryetar nesra që do të vjen, sepse e ka obligu vendimi I Kuvendit komunal. Unë kam qenë këshilltar I Kuvendit Komunal kur e kemi pru vendimin, që ansambli “Kemajl Azizi” të financohet nga subvencionet e drejtorisë 25%, nuk ka pas kurgja të keqe, gjithçka ka qenë e mirë dhe është e mirë edhe sot, janë disa plasaritje të cilat tybe nuk I di unë saktësisht, po e di që është lufta për kryetar. Këtu nuk ka të bej me politik. Ishte propozimi I Bekimi me ju dhënë afat, nuk e di a kemi të drejtë ligjore me jav nal, kemi, unë pajtohem plotësisht, sepse unë kam qenë pro atij vendimi, e tash edhe kuvendi ka të drejt me terjek at vendim, po konsideroj që nuk na bënë nder me terjek. Unë konsideroj me bë presion të aspekti shoqëror, që kjo suate që është kriju në ansamblin “Kemajl Azizi”, sa me shpejt të zgjidhet. Na bën nder të gjithëve, besoj që mund të zgjidhet kjo problematik.

Kryesuesi z.Naim Pira: Si konstatim ndoshta I përgjithshëm është që shoqëria kulturore artistike le te ulen le ta bisedoj këtë çështje, sepse ne një mënyrë ne jemi ata që e subvencionojmë

me 25% të buxhetit të Drejtorisë së Kulturës, le të merren vesh për hapat e mëtejshme, le të mbet si rekomandim I Kuvendit Komunal, akteret që janë të implikuar në këto situata le të ulen bashkë me neve sa kemi mundësi me dhënë kontribut, që këtë çështje ta përmbyllmi. Unë po besoj që ky është mesazhi me I mirë, sepse kjo shoqëri I duhet Komunës së Vitisë. Nëse nuk arrinë këta marrëveshje, ne e kemi mekanizmin, e kemi kuvendin dhe I marrmi hapat e mëtejshëm, po ajo nuk ka me I konvenu tani as shoqërisë, as neve si komune. Unë ju falënderoj të gjithëve për kontributin që dhatë, mirupafshim ne seancat e radhës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 13:00 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Naim Pira
